

Në bazë të nenit 13, paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimin e shumës së honorarëve për shërbimet e tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 të datës 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023 dhe nr. 01-197/3 të datës 15.04.2024, dhe në lidhje me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për trajnimin dhe provimin për drejtorët e shkollave fillore, shkollave të mesme, konvikteve shkollore dhe universiteteve të hapura civile për mësim gjatë gjithë jetës ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë", nr. 10/15, 145/15, 192/15, 30/16, 120/18 dhe 140/18), Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup publikon:

KONKURS PUBLIK I PËRSËRITUR
për përzgjedhjen e bashkëpunëtorit të jashtëm - zëvendës anëtar
të Komisionit për dhënien e provimit për drejtorë të shkollës fillore, shkollës së mesme, konvikteve shkollore dhe universitetit të hapur civil për mësim gjatë gjithë jetës

Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorit të jashtëm - zëvendës anëtarë të Komisionit për dhënien e provimit për drejtorë të shkollës fillore, shkollës së mesme, konvikteve shkollore dhe universitetit të hapur civil për mësim gjatë gjithë jetës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- të ketë përfunduar së paku një arsim të lartë – shkalla VII/2 ose 300 kredi sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (SETK) nga fushat që mbulojnë modulet Aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe kompjuterit në menaxhim në arsim/ Teoria e organizimit/ Njerëzit në organizata/ Drejtori si drejtues pedagog/Financa/ Legjislacioni;
- të jetë i punësuar në një institucion të arsimit të lartë;
- të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore dhe
- të ketë punime të botuara profesionale, domethënë shkencore, që janë në funksion të fushës përkatëse.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- fletëparaqitje e plotësuar (formulari i aplikimit është i postuar në ueb faqen www.dic.edu.mk);
- një kopje të certifikatës/diplomës për arsimin e përfunduar së paku të lartë – shkalla VII/2 ose 300 kredi sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (SETK) nga fushat që mbulojnë modulet Aplikimi i teknologjisë informative-kompjuterike në menaxhim në arsim/ Teoria e organizimit/ Njerëzit në organizata/ Drejtori si drejtues pedagogjik/ Financa/ Legjislacioni, i noterizuar ;
- vërtetim për të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose veprimtari shkencore në origjinal ose në kopje të noterizuar;
- vërtetim se janë të punësuar në një institucion të arsimit të lartë;
- kopje të faqes së parë të punimeve profesionale, domethënë shkencore të botuara që janë në funksion të fushës përkatëse.

Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm - anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit për drejtorë të shkollës fillore, shkollës së mesme, konvikteve shkollore dhe universitetit të hapur civil për mësim gjatë gjithë jetës, bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimin e masës së honorarëve dhe tarifave për shërbimet e tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Komisionit për dhënien e provimit për drejtorë të shkollës fillore, shkollës së mesme, konvikteve shkollore dhe universitetit të hapur civil për mësim gjatë gjithë jetës ka një mandat 4 (katër) vjet.

Konkursi zgjat deri më 29.11.2024.

Fletëparaqitja e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohet EKSKLUZIVISHT ME POSTË me postë rekomande, ose me postë të shpejtë në adresën në vijim: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" pn 1000 Shkup, me shënimin "Për konkurs publik për bashkëpunëtorë të jashtëm - anëtarë të komisionit të provimeve".

Fletëparaqitjet e mëposhtme nuk do të merren parasysh:

- fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit;
- fletëparaqitjet e plotësuara jo të plota;
- fletëparaqitjet për të cilat nuk është dorëzuar dokumentacioni i përcaktuar;
- fletëparaqitjet që nuk dorëzohen me postë të regjistruar ose me postë të shpejtë.

Informacione shtesë për konkursin mund të merren në numrin e telefonit 075 300 606, çdo ditë pune, nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP